



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VKB NR 72 DATË 02.12.2021

MBI MIRATIMIN E NGRITJES SË BORDEVE TË KOPSHTEVE DHE MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR NGRITJEN DHE FUQIZIMIN E BORDIT TË KOPSHTIT”

Këshilli i Bashkisë Dimal në mbledhjen e datës 02/12/2021, mbi bazën e materialit të paraqitur nga Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Neni 23, Neni 54, Neni 55, Në bazë të Ligjit Nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 25, datë 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”, Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë, Udhëzimi i përbashkët Nr.17, datë 16.8.2021 “Për vitin shkollor 2021-2022 në sistemin arsimor parauniversitar”;

VENDOSI

Me 13 vota PRO nga 13 Këshilltarë prezentë të miratojë :

- 1.Themelimin e Bordit të Kopshtit dhe funksionimin e plotë të tij në çdo kopësht nën juridiksionin e Bashkisë Dimal.
- 2.Miratimin e Rregullores “Për ngritjen dhe fuqizimin e Bordit të kopshtit”.
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet “Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve në Bashkinë Dimal dhe edukatorët e arsimit parashkollor”.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Hysen Hoxha

